



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo



Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

NJËSIA E BURIMEVE NJËRZORE

Nr. 13-111/01-0022700/25

Datë 23.04.2025

Në bazë të nenit 78, paragrafi 2, nenet 81 dhe 82 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197, në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 90/2010), nenit 5, pikës c, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, të Ligjit për Arsimin në Komunat e Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021 (MASHT) të datës 18.06.2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm dhe Rregullores (QRK nr. 19/24) si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të punës, Komuna e Podujevës shpallë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Nr.	Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vendi lirë/Zëvendësim	Koeficienti
1.	ShFMU	“Rilindja”	Herticë	Mësimdhënës/e për lëndën Histori Ed. Qytetare	I lirë	6.1
2.	ShFMU	“Jahë Hasani”	Bërvenik	Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë Angleze	Zëvendësim	6.1

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë - Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rrëfimi personal (CV);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat në vend të diplomës) të noterizuara;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Certifikata shëndetësore e lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore. (pas pranimit në punë)
- Licencën e mësimdhënësit (për mësimdhënësit fillestar nuk kërkohet licenca me rastin e aplikimit në konkurs).
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Kriteret e kualifikimit për pozitën Histori-Edukatë Qytetare

- Niveli master arsimor (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Kriteret e kualifikimit për pozitën Gjuhë Angleze

- Niveli master arsimor (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit (CV) (deri 20 pikë)
- Testi me shkrim (deri 50 pikë)
- Intervista me gojë (deri 30 pikë)
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë.
- Pikat nga vlerësimi i jetëshkrimit (CV), testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumen e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura.
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të nostrifikojnë diplomat nga MASHT.
- Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje, sepse nuk kthehen.

Afati i aplikimit: Koha e aplikimit është shtatë (7) ditë kalendarike nga data 24.04.2025 deri më datën 30.04.2025. Përveç web-faqes unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>.

Mënyra e aplikimit: Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>) apo t'i shkarkojnë nga web-faqja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohet dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web-faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës, pas mbylljes së konkursit.